

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Shala, kryetar i kolegjit, Valon Totaj dhe Lumni Sallauka, anëtarë në çështjen kontestimore të paditësit B.B. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit të cilin me autorizim e përfaqëson N.A. avokate nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën me autorizim e përfaqëson F.M., për shkak të mos pagesës së pagave, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/2014 të datës 11.02.2015, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 06.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/14 i datës 11.02.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë C.nr.417/14 të dt.11.02.2015, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B., nga fshati, Komuna e Lipjanit dhe është detyruar e paditura Komuna e Lipjanit, që paditësit të ia paguaj shumën prej 1944 euro, në emër të pagave të pa paguara , për punët dhe detyrat e punës së mësimdhënësit të gjuhës angleze në SHFMU Emin Duraku në fshatin Banullë, për periodën prej 01.09.20011 e deri më 28.02.2012, me kamat vjetore sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat në Kosovë për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, që nga data 22.08.2014 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 279,20 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit.

E paditura Komuna e Lipjanit, përmes të autorizuarës F.M., në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të ankimuar për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të prishet dhe lënda të kthehet në rivendosije.

Paditësi përkatësisht e autorizuar e tij N.A. avokate nga Lipjani, ka dhënë përgjigje në ankesë duke i propozuar Gjykatës së shkallës së dytë që ta refuzoj ankesën e të paditurës dhe ta vërtetoi aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ankesës së të paditurës, përgjegjës në ankesë të paditëses në bazë të dispozitës së nenit 194, 200 të LPK-së, vlerëson se:

Ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi B.B. me datë 22.08.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për shkak të mos pagesës së të ardhurave personale kundër të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor dhe i ka administruar provat e propozuara si: ka lexuar kontratën e punës Nr.4-112-813/896 e dt.01.09.2011; kërkesën e ushtruar nga paditësi për pagesën e pagave drejtuar të paditurës të dt.08.08.2014, si dhe specifikacionin e punës së kryer nga punëmarrësi e tani paditësi të dt.10.12.2014, të lëshuar nga e paditura, dhe pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku konform nenit 8 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se kërkesëpadija e paditësit, për kompensimin e pagave është e bazuar dhe si e tillë e ka aprovuar në tërësi. Nga kontrata e punës Nr. 4-112-813/896 të datës 01.09.2011 është vërtetuar se paditësi në SHFMU “Emin Duraku” në Banullë, me të cilën menaxhon e paditura, ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar për periudhën prej 01.09.2011 e deri më 28.02.2012, në vendin e punës si mësimdhënës i gjuhës angleze për 20 orë punë në javë dhe pagën mujore prej 324,00€. Me kërkesën e datës 08.08.2014 me Nr. 04-400-31379 paditësi i është drejtuar të paditurës për pagesën e pagave të papaguara për periodën kontestuese, dhe nga specifikacionin i punës së kryer nga punëmarrësi e tani paditësi, i lëshuar nga pala e paditur me datën 10.12.2014 është vërtetuar se e paditura për punën e kryer për periudhën prej 01.09.2011 e deri më 28.02.2012 në SHFMU “Emin Duraku” paditësit i ka mbetur borxh për shumën prej 1944 euro. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se në mes ndërhyrësve nuk kanë qenë kontestuese faktet se paditësi i ka përmbushur detyrimet e veta kontraktuese por nga ana e të paditurës nuk iu janë paguar pagat, në mbështetje të nenit 55.1 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012 e ka aprovuar kërkesëpadija e paditësit si të bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditurës, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i kuptueshëm, i qartë dhe i

përmbareshëm e po ashtu nuk është në kundërshtim me arsyet e dhëna në aktgjykim, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet vendimtare dhe ka marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Po ashtu edhe sa i përket pretendimit se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike edhe ky pretendim ankimor i të paditurës nuk qëndron nga se vetë e paditura në ankesë por edhe në shqyrtim kryesor në gjykatën së shkallës së parë e pranon se paditësit nuk ju kanë paguar pagat për shkak të rrethanave buxhetore të paditurës, pasi që qeverisja e kaluar komunale nuk ka planifikuar buxhet.

Nga të cekuar më lartë Gjykata e Apelit e Kosovës e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 195 parag.1 pika d) të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.972/15 datë 06.08.2018

Kryetari i Kolegjit
Burim Shala .d.v.